

Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete

Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete (ZKKKK) është mekanizëm mbrojtës në nivel lokal që është i detyrueshëm në komunat ku komunitetet përbëjnë të paktën dhjetë për qind të popullsisë së komunës. ZKKKK është i mandatar për shqyrtimin e ankesave të pjesëtarëve të komuniteteve në lidhje me shkelje të të drejtave të tyre përmes akteve ose vendimeve të kuvendit të komunës, dhe është përgjegjës për t'i paraqitur pretendimet e tilla para kuvendit të komunës. ZKKKK mund të kërkojë rishqyrtimin e aktit ose vendimit përkatës. Në rrethana të caktuara, ZKKKK mund t'i drejtohet gjithashtu Gjykatës Kushtetuese për aktet ose vendimet që konsiderohet se shkelin të drejtat e garantuara me kushtetutë. Në komunat ku komunitetet joshumicë e arrijnë pragun prej dhjetë për qind, kjo pozitë rezervohet për përfaqësuesin e komunitetit joshumicë që ka marrë më së shumti vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës.

Dokumentet kryesore

- Kushtetuta, neni 62(1) dhe (2);
- Ligji për vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040, 2008);
- Udhëzimet për Zëvendëskryesuesin e Kuvendit të Komunës për Komunitete.

Themelimi

Pozita e ZKKKK është krijuar në 11 komuna.

Pozitat e krijuara të ZKKKK *

Dragash	Novobërdë
Fushë Kosovë	Prizren
Gjilan	Shtërpçë
Graçanicë	Zubin Potok ¹
Kllokot	Zveçan ¹
Mitrovicë Veriore ¹	

¹ Mungesa e të dhënave nga regjistrimi i popullsisë krijon paqartësi për sa i përket themelimit të kësaj pozite për këto komuna. Prandaj, për qëllime të kësaj analize janë përdorur vlerësimet e numrit të popullsisë në Profilet e komunave të Kosovës të përpiluara nga Misioni i OSBE-së në vitin 2018. (Gjendet tek <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>)

* **Me shkronja të zeza të theksuara** janë të paraqitura komunat ku ZKKKK-të janë të detyrueshëm sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë.


Të gjitha pozitat e detyrueshme të ZKKK janë themeluara.

Qasja në burime financiare

Që të gjithë ZKKKK-të (100 për qind) kanë raportuar sfida për sa i përket qasjes në burime adekuate financiare. Në shumë raste nuk ndahen mjete financiare të destinuar enkas për funksionin e tyre, ose u duhet të mbështeten tek organet tjera komunale për përkrahje financiare ose logjistike.


Përbërja gjinore dhe përfaqësimi i komuniteteve

Përfaqësimi i komuniteteve



- Shqiptarë të Kosovës
- Serbë të Kosovës
- Turq të Kosovës
- Goranë të Kosovës
- Egjiptianë të Kosovës

Përbërja gjinore



- Gra
- Burra

Performanca në vitin 2021


Treguesit e përzgjedhur të performancës

Numri i ZKXXX-ve që i kanë realizuar aktivitetet kryesore dhe detyrat themelore të përcaktuara me kornizën ligjore dhe të politikave, bazuar në monitorimin e rregullt dhe shqyrtimet periodike nga ekipet në terren të Misionit të OSBE-së në Kosovë, si dhe raportet e komunave.

Shënim: krahasimi është bërë ndërmjet 12 muajve të vitit 2020 dhe 10 muajve të vitit 2021, si rrjedhojë e zgjedhjeve lokale të mbajtura në tetor 2021.

1 – Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve


Shqyrtimi i pretendimeve për shkelje të të drejtave të komuniteteve me aktet ose vendimet e kuvendit të komunës



Gjatë periudhës së raportimit, asnjë ZKXX nuk parashtroi për shqyrtim pretendime për shkelje të të drejtave të komuniteteve në Gjykatën Kushtetuese.


2 – Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve

Angazhimi në aktivitete për promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve




3 – Raportimi

Ofrimi i informatave të organet tjera komunale lidhur me aktivitetet dhe punën e tij




4 – Bashkëpunimi

Pjesëmarrja në mbledhjet e Komitetit për Komunitete




Bashkëpunimi në shqyrtimin e politikave komunale që prekin interesat e komuniteteve



5 – Komunikimi dhe konsultimi

Lehtësimi i përfshirjes së komuniteteve në punën e kuvendit të komunës



Performanca e ZKXXX-ve është mesatarisht e mirë dhe e krahasueshme me vitin 2020 në shumicën e sektorëve. Angazhimi i ZKXXX-ve në promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve ka shënuar rënie në vitin 2021, ndërsa komunikimi me organet tjera komunale është përmirësuar.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ofron mbështetje për pjesëmarrjen e shtuar të komuniteteve në proceset e vendimmarrjes dhe të qeverisjes publike, si edhe në institucione. Në suazat e këtyre përpjekjeve, Misioni i OSBE-së në Kosovë e monitoron rregullisht punën e mekanizmave komunalë për mbrojtjen e komuniteteve. Këto fletushka informuese kanë si qëllim që institucioneve përkatëse t'u ofrojnë tregues që mund t'u ndihmojnë në identifikimin e mangësive dhe përmirësimin e pajtueshmërisë.